


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË TIRANË

Nr. 1108 Rep.
Nr. 1P6 Kol.

*Palis faktore
pajmar sipas detyrës*



KONTRATE KONCESIONI

E FORMES "BOT" (NDERTIM - OPERIM - TRANSFERIM) PER NDERTIMIN E HIDROCENTRALIT 'SELISHTE'

Ne Tirane, me date 11, muaji May, viti 2008 (dy mije e tete), u paraqiten para meje notere Gentiane D. Meksi, regjistruar ne Dhomen e Noterise Tirane me adrese Dr. Jusrova R. 118 SH / T.P. 1, palet kontraktuese si me poshte:

Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjetikes, qe me poshte do te quhet "AUTORITET KONTRAKTUES", percaktuar me Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 552, date 29.08.2007, perfaqesuar me autorizimin nr. 1597/5, date 13.02.2008, nga z. Kristo Rodi, i datelindjes _____, banues n _____, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, per identitetin e te cilit u sigurova nga pasaporta me nr. _____

DHE

Shoqerise "IRZ" sh.p.k., regjistruar si person juridik me Vendimin nr. 2656, date 10.03.1994, te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, me seli ne Rruga Don Bosko, perballe "parkut te autobuzeve", regjistruar ne organin tatimor me nr. Nipt J72207019C, date 22.11.2004, qe me poshte do te quhet "Koncesionari", perfaqesuar nga administratori z. Ramazan Biba, i datelindjes _____, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, u sigurova nga pasaporta me nr. _____

Hyrje

Duke patur parasysh se:

Qeveria e Shqiperise:

1. I ka dhene nje rol prioritar prodhimit, transmetimit dhe shperndarjes se energjise elektrike nepermjet ndertimit te hidrocentraleve te rinj ose rehabilitimit te hidrocentraleve ekzistuese me ane te procedurave te koncesionit, per permissimin e treguesve teknike dhe ekonomike te rrjetit elektrik kombetar;



2. Konsideron ndertimin e hidrocentraleve si nje element te rendesishem te politikës se zhvillimit te sektorit te energjise.
3. Vlereson formen "BOT" te konçesionit, si nje forme konçesioni qe ben te mundur nxitjen e investitoreve private per ndertimin e hidrocentraleve te rinj me anen e kapitalit privat;
4. Eshte e angazhuar per krijimin dhe zhvillimin e tregut te brendshem te energjise elektrike brenda vendit;
5. Mirepret investitoret vendas ose te huaj ne ndertimin e kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike.

Konçesionari:

1. Ka kryer studimin tekniko-ekonomik dhe mjedisor, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e hidrocentraleve te siperpermendura, si një propozim i pakërkuar, dhe në përfundim të procedurës përzgjedhëse konkurruese është vlerësuar si ofertuesi më i mirë.
2. Eshte i interesuar te investoje ne ndertimin e hidrocentralit Selishte, komuna Selishte, rrethi Diber, me qellimin prodhimin e energjise elektrike dhe rritjen e sigurise te furnizimit me energji elektrike te zones;
3. Shoqeria "IRZ"sh.p.k. zoteron kapacitetet e nevojshme tekniko-financiar, per te realizuar projektin e miratuar sipas objektit te kesaj marreveshje;
4. Zoteron aftesite drejtuese, financiare dhe teknike te kerkuara si dhe aftesite per te plotesuar kete iniciative ne perputhje me standartet nderkombetare.


Palët lidhin këtë kontratë konçesioni bazuar në Ligjin nr.9663 dt.18.12.2006 "Për konçesionet" dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 274, date 04.05.2007 "Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për ndërtimin me konçesion të hidrocentraleve dhe bien dakort për sa më poshtë:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1
Perkufizime dhe interpretime**

Kudo qe ne kete Marreveshje perdoren termat e meposhteme, ato do te kene kuptimet perkatese si me poshte si vijon :

- 1.1. **Kontrata e Konçesionit** : Kjo kontratë, aneksi/aneokset dhe çdo dokument tjetër që do të bashkëlidhet me të si pjesë përbërëse dhe e pandarë.
- 1.2. **Ligji "Për Konçesionet"**: Ligji nr.9663 dt.18.12.2006 "Për konçesionet"
- 1.3. **Autoriteti Kontraktues**: Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

- 
- 1.4. **Konçesionari:** Shoqeria "IRZ" Sh.p.k, me seli ne rruga "Don Bosko", ne qytetin e Tiranës.
 - 1.5. **Hidrocentral:** Hidrocentrali Selishte, me vendndodhje në komunën Selishte, rrethi Diber, me fuqi të instaluar 1,350 (njemije e treqind e pesedhjetë) kW dhe prodhim të energjisë elektrike rreth 8,400,000 (tetemilion e katerqind mije) kWh, i përbërë nga tërësia e objekteve që shërbejnë për prodhimin e energjisë elektrike duke përfshirë por pa u kufizuar në to: veprën e marrjes, kanalën e devijimit, bazenin e presionit, tubacionin që dërgon ujin në turbina, lidhjen me sistemin, ndërtesën e centralit së bashku me makineritë dhe pajisjet e intaluara në të.
 - 1.6. **Objekti:** Financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajta e hidrocentraleve dhe transferimi i tij nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues.
 - 1.7. **Investimi:** Vlera totale në lekë që do të shërbejë për ndërtimin dhe paisjen me makineritë e nevojshme të Hec-it, deri në fillimin e prodhimit të energjisë elektrike.
 - 1.8. **Punimet:** Tërësia e veprimeve për projektimin inxhinierik, ndërtimin dhe vënien në punë të hidrocentralit Selishte, ne perputhje me projektin e zbatimit.
 - 1.9. **Fillimi i punimeve:** Zbatimi i projektit pas miratimit të tij sipas nenit 8 pika 2 e kësaj kontrate.
 - 1.10. **Vënia në punë e hidrocentralit:** Fillimi i prodhimit të energjisë elektrike pas testimit sipas nenit 11 të kësaj kontrate.
 - 1.11. **Kontratat:** Te gjitha kontratat e nenshkruara nga Konçesionari, me sipërmarresit për realizimin e punimeve ose cdo marrëveshje tjetër e lidhur me të tregtet që ka si objekt operimin e hidrocentralit dhe/ose sigurimin e fondeve financiare.
 - 1.12. **Leje dhe Liçenca:** Akte administrative, që lëshohen nga autoritetet përkatëse publike për të bërë të mundur ushtrimin e veprimtarisë sipas objektivit të kësaj kontrate, bazuar në legjislacionin në fuqi.
 - 1.13. **Operimi:** Te gjitha veprimet e koncesionarit për prodhimin, furnizimin, transmetim, shpërndarje, eksportim dhe shitje të energjisë elektrike, ne perputhje me kushtet e kësaj kontrate.
 - 1.14. **Tarifa konçesionare:** Sasia vjetore e energjisë elektrike e shprehur në përqindje, që i jepet pa pagesë Autoritetit Kontraktues.
 - 1.15. **Llogaritja e afateve:** Kur afati është caktuar me ditë, përjashtohet dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të fillojë afati. Afati që është caktuar në muaj ose në vite mbaron me kalimin e asaj dite numerike të javës së fundit ose të muajit të fundit që ka të njëjtin emër ose numër me atë të ditës numerike që ka filluar afati. Kur një ditë e tillë mungon në muajin e fundit afati mbaron me kalimin e ditës së fundit të këtij muaji. Kur dita e fundit e një afati bie në ditë pushimi, afati mbaron në ditën e punës, që vjen pas asaj të pushimit.
 - 1.16. **Subjekti i furnizimit me energji elektrike:** Personi i liçencuar për furnizimin me energji elektrike të konsumatorëve në bazë të legjislacionit shqiptar.
 - 1.17. **Sigurimi i kontratës:** Vlera monetare e ngurtësuar në një llogari të posaçme me qëllim që të garantojë Autoritetin Kontraktues në rastet e shkeljes së kontratës nga Konçesionari, sipas Nenit 14.
 - 1.18. **Ligj:** Nenkupton cdo ligj organik, dekret, vendim i Keshillit të Ministrave ose cdo ligj tjetër që shpallet si i tillë, rregullore, udhëzim, urdher, license, leje, autorizim ose cdo akt tjetër ligjor i shpallur nga Republika e Shqipërisë, vendime gjyqësore që kanë karakter unifikues, akte zyrtare të leshuara nga cdo organ qendror dhe/ose vendor, ashtu sic mund të ndryshojnë gjatë kohegjatjes së kësaj Kontrate.
 - 1.19. **Enti Rregullator i Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE):** Është institucioni rregullator i sektorit të energjisë elektrike që vepron sipas Ligjit nr. 9072 datë 22.05.2003.

- 1.20. **Aneks:** Cdo deklaratë, vertetim, autorizim, vendim, urdher ose dokument tjetër i nënshkruar nga palet që i bashkelidhet kësaj Kontrate, si pjesë perberese dhe e pandare e saj, tani apo në të ardhmen.

Neni 2 Objekti i Konçesionit

- 2.1 Objekti i kësaj kontrate konçisioni është :

Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues, konform termave dhe kushteve të kësaj kontrate.

Me anë të kësaj kontrate Autoriteti Kontraktues i autorizuar nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë në bazë të ligjit "Për konçesionet", i jep Konçesionarit me konçesion të formës BOT (që do të thotë ndërtim, operim dhe transferim i së drejtës së pronësisë dhe operimit, në përfundim të kontratës së konçesionit):

Financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, administrimin, mirëmbajtjen e hidrocentralit Selishte dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës nga Konçesionari tek Autoriteti Kontraktues, konform kushteve dhe afateve të kësaj kontrate.

Neni 3 Karakteristikat e hidrocentralit

- 3.1 Hidrocentrali Selishte do të ndërtohet mbi perrenjte Perroi i Madh dhe Qafe Murres, në fshatin Selishte, komuna Selishte, rrethi Dibër, me këto karakteristika:

- Kuotat e vepres:
 - Kuota e vepres së marrjes 736 m
 - Kuota e godines së centralit 643m
 - Fuqia e Instaluar 1,350 kW
 - Prodhimi i energjisë elektrike 8,400,000 kWh

Neni 4 Kohëzgjatja e Kontratës së Konçesionit

- 4.1 Autoriteti Kontraktues i jep Konçesionarit me konçesion të formës "BOT", në përputhje me nenin 2, me siper, hidrocentralin për një periudhë 35 vjeçare.
- 4.2 Një vit para përfundimit të kësaj periudhe, palët me vullnet të përbashkët mund të zgjasin afatin e kësaj kontrate, kur vlerësohet se, nga ana e Konçesionarit janë përmbushur me korrektësi të gjitha detyrimet dhe Autoriteti Kontraktues e konsideron me interes vazhdimësinë e kontratës.
- 4.3 Kjo periudhë do të fillojë nga hyrja në fuqi e kësaj Kontrate.

KREU II TE DREJTAT DHE DETYRIMET E AUTORITETIT KONTRAKTUES

Neni 5 Pronësia dhe dorëzimi i aseteve të projektit

5.1 Titulli i pronësisë

E drejta e pronësisë mbi asetet pronë shtetërore (ku përfshihen po nuk kufizohen toka ku do të ndërtohen hidrocentralet, toka ku shtrihet shtrati natyror i perrenjve, toka në të dy anët e argjinaturave) që do t'i shërbejnë objektit të kontratës së konçesionit, gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, i mbetet Autoritetit Kontraktues ose organit të administratës qendrore sic mund të parashikohet ndryshe gjatë kohëzgjatjes së Kontrates.

5.2 Konflikte mbi titullin e pronësisë

Në rast konflikti mbi titullin e pronësisë, në përputhje me paragrafin e mësipërm, Autoriteti Kontraktues merr përsipër t'i zgjidhë ato, për t'i garantuar Konçesionarit shfrytëzimin e qetë dhe pa pengesa.

Neni 6 Monitorimi dhe Mbikqyrja e Përgjithshme

6.1 Monitorimi

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë që në periudha kohore prej 3 muajsh, gjatë periudhës së konçesionit, nëpërmjet të autorizuarve të tij, të monitorojë objektin e konçesionit për të verifikuar zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga kontrata në të gjitha fazat e zbatimit të saj.

Megjithatë, Autoriteti Kontraktues mund të ushtrojë këtë monitorim në çdo kohë në rast se ka informacione të arsyeshme dhe të besueshme në lidhje me mosekzekutimin e detyrimeve të kësaj Kontrate.

6.2 Mbikqyrja e përgjithshme e punimeve

Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të ushtrojë një mbikqyrje të përgjithshme me afate tre mujore, gjatë realizimit dhe vënies në punë me synim që të verifikojë se ecuria e punimeve, cilësia dhe konformiteti të jenë në përputhje me programin e përgjithshëm të realizimit dhe të dokumentacionit të projektit.

Në rast të shkeljeve të Kontratës, të konstatuara gjatë mbikqyrjes së përgjithshme, Konçesionari do të njoftohet me shkrim për masat që do të merren dhe detyrat që do t'i lihen, si dhe mënyrën dhe afatet e zbatimit të tyre.

Detyrimet e Autoritetit Kontraktues

Autoriteti Kontraktues merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

1. Të sigurojë vazhdimësinë e kontratës pavarësisht ndryshimeve të objektivave strategjike kombëtar dhe të sektorit.
2. Të ndihmojë Konçesionarin pranë çdo institucioni shtetëror dhe organi vendor, kur është e nevojshme për marrjen e licencave ose lejeve që do t'i shërbejnë për ekzekutimin e punimeve dhe implementimin e kësaj kontrate.
3. Te miratoje projektin e Zbatimit të hidrocentralit, të përgatitur nga vetë Konçesionari, në përputhje me propozimin për të cilin është shpallur fitues në procedurën e garës.
4. Të ndihmojë Konçesionarin në marrëdhënie dhe në lidhjen e marrëveshjeve/kontratave me institucione publike për qëllime të realizimit të objektivit të kësaj kontrate.
5. Te garantoje, nëse kërkohej nga Konçesionari, detyrimin e subjektit të furnizimit të energjisë elektrike për të blerë energjinë elektrike të prodhuar nga këto hidrocentrale, nëpërmjet nënshkrimit të një kontrate të posaçme. Kohëzgjatja e kësaj kontrate do të jetë për një periudhë kohore prej jo më pak se 4 vjet dhe e rinovueshme në rast se kërkohej nga Konçesionari. Rinovimi i kësaj kontrate mund të kërkohej deri në 4 here dhe përtej këtij numri, Konçesionari do të negociojë me subjektin e furnizimit të energjisë elektrike. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga kjo kategori hidrocentralesh do të llogaritet nga Enti Rregullator i Energjisë.
6. Të garantojë Konçesionarin që ndërtimi i veprave të tjera hidroteknike në të njëjtën rrjedhë, nuk do të ndikojë në mbarëvajtjen e projektit të Konçesionarit.
7. Autoriteti Kontraktues me kërkesë të Konçesionarit merr përsipër të bëjë të gjitha përpjekjet për të asistuar këto të fundit tek organet shtetërore për çdo pengesë që mund të haset në kuadër të pajisjes me leje, licensa, autorizime apo çdo lloj tjetër leje që nevojitet për operimin e kësaj vepre. Ky parashikim nuk është i zbatueshëm kur mospajisja me leje, licensë, autorizim, etj, vjen si rezultat i mospërbushjes së kërkesave ligjore përkatëse për shkak të Konçesionarit.
8. Autoriteti Kontraktues është përgjegjës për detyrimet ligjore dhe kontraktore në rast të mospërbushjes së këtyre detyrimeve nga ana e tij duke shpërblyer të gjitha demtet e shkaktuara ndaj Konçesionarit dhe që kanë të bëjnë me kthimin e vlerës së investimit të kryer (vlera e asetëve në momentin zgjidhjes së kontratës), sigurimin e kontratës (nëse ka) dhe shpërblimin e demtit për shkak të shkeljes së kushteve të përcaktuara në kontratën e konçesionit.

KREU III TE DREJTAT DHE DETYRIMET E KONÇESIONARIT

Neni 8 Detyrimet e Konçesionarit

- 8.1 Konçesionari është i detyruar të zbatojë Projektin dhe objektin e Kontratës konform termave dhe kushteve të saj.

Veçanërisht Konçesionari duhet që:


1. Të themelojë brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga hyrja në fuqi e Kontratës së Konçesionit, shoqërinë konçesionare, që do të ketë si objekt të veprimtarisë së saj vetëm financimin, projektimin, ndërtimin, vënien në punë, operimin, administrimin, mirëmbajten e hidrocentralit dhe transferimin e tij në përfundim të kontratës tek Autoriteti Kontraktues, në zbatim të nenit 2, të kësaj Kontrate.

Shoqëria e krijuar do t'i nënshtrohet të gjitha dispozitave ligjore, që rregullojnë veprimtarinë e shoqërive tregtare në Shqipëri, duke patur parasysh që të gjitha të drejtat dhe detyrimet e parashikuara në këtë kontratë për Konçesionarin do t'i mbeten këtij të fundit deri në përfundim të kësaj Kontrate.

Një kopje e aktit të themelimit, statutit dhe regjistrimit të shoqërisë së re si person juridik, do t'i dorëzohet Autoritetit Kontraktues brenda 10 ditëve nga data e regjistrimit, për të marrë miratimin e këtij të fundit, duke patur parasysh që miratimi i këtij të fundit të jepet brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes së dokumentit përkatës. Në rast vonesë për shprehjen e miratimit, konsiderohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka vërejtje apo sugjerime në lidhje me themelimin e personit të ri juridik.

Në mënyrë të veçantë kërkohej që statuti të përmbajë të pakten:

- i. Forma e shoqërisë: Forma e shoqërisë do të jetë "shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose "shoqëri anonime", duke funksionuar në zbatim të ligjit nr. 7638, datë 19.12.1992, "Për Shoqëritë Tregtare";
 - ii. Objekti i shoqërisë: Ndërtimi, operimi dhe transferimi i hidrocentralit Selishte tek Autoriteti Kontraktues, ku përfshihet financimi, ndërtimi, vënia në punë, prodhimi, furnizimi, transmetimi, shpërndarja, eksportimi dhe shitja e energjisë elektrike, në zbatim të kësaj Kontrate Konçesionari. (Nuk lejohet asnjë lloj tjetër veprimtarie tregtare përveç atyre që ushtrohen në kuader të kësaj Kontrate);
 - iii. Kohezgjatja: Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me afatin e kësaj Kontrate Konçesionari;
 - iv. Themelues i shoqërisë: Shoqëria e re do të themelohet nga Konçesionari në cilësinë e ortakut/aksionerit të vetëm.
2. Të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktues, për miratim projektin e zbatimit, brenda 6 muajve nga data e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
 3. Të marrë të gjitha lejet dhe licencat e nevojshme për realizimin e kësaj kontrate në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi.

- 
4. Të zbatojë punimet dhe planin e investimit sipas Aneksit 1 bashkëlidhur kontratës;
 5. Të marrë masa që çdo investim të bëhet sipas afateve të përcaktuara dhe me cilësinë e kërkuar në këtë Kontratë;
 6. Të zbatojë projektin për ndërtimin e Hec-it me fuqi të vendosur jo më pak se 1,350 kW;
 7. Të administrojë projektin për periudhën e koncesionit;
 8. Të kërkojë nese e gjykon me interes dhe të pershtatshme, zbatimin e detyrimit të Autoritetit Kontraktor sipas pikës 5 të nenit 7, me siper.
 9. Të përballojë të gjitha shpenzimet që lidhen me dëmet që eventualisht mund t'i shkaktohen Autoritetit Kontraktor apo paleve të treta.
 10. Të mbajë të informuar Autoritetin Kontraktues për çdo rrethanë që mund të ketë ndikim në ecurinë e projektit;
 11. Të marrë masa për të garantuar respektimin e dispozitave të Kodit të Punës dhe rregulloreve përkatëse të sigurimit teknik, të disiplinës teknike, të mbrojtjes në punë, të higjienës dhe sigurimit nga zjarri, për të parandaluar çdo dëm e fatkeqësi në punë.
 12. Në veprimtarinë e tij të zbatojë legjislacionin shqiptar në fuqi;
 13. Të paguajë të gjitha shpenzimet për publikimet e bëra, si dhe shpenzimet noteriale.
 14. Koncesionari ka të drejtë, kundrejt zgjedhjes së tij për shitjen e energjisë që i përket pjesës së tij të energjisë elektrike të prodhuar nga hidrocentralet, po ashtu me qëllim marrjen e certifikatave të gjelberta apo ndonjë nxitje tjetër ekuivalente, që ka të bëjë me prodhimet e energjisë të rinovueshme, duke patur parasysh parashikimin e pikës 8 të këtij neni.
 15. Në kuadër të zbatimit të punimeve për realizimin e projektit, bazuar në ligjin nr. 8402, datë 10.9.1998, "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe Udhezimit të Keshillit të Ministrave nr. 3, datë 15.2.2001, "Për mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit", Koncesionari është i detyruar të emerojë një subjekt në rolin e mbikqyrësit të punimeve. Ai mund të jetë person fizik, juridik, vendas apo i huaj, i pajisur me licencën përkatëse për ushtrimin e kesaj veprimtarie.

Neni 9 Vleresimi i Investimeve

- 9.1 Mbi bazën e të dhënave të projektit, investimet që duhet të kryhen nga koncesionari janë në vlerën totale prej 120,000,000 (njëqind e njëzetmilion) leke, nga të cilat 57,000,000 (pesëdhjetë e shtatëmilion) leke do të investohen në makineri e pajisje, sipas Aneksit nr. 2.

9.2 Vleresimi i mesiperm mund te pesoje ndryshime te mundshme, me marreveshje ndermjet paleve:

- pas variantit perfundimtar te projektzbatimit
- ne çdo kohe gjate zbatimit te projektit ne ndertimin e vepres, sipas efektivitetit te ofertave

9.3 Vlera e ndryshuar e investimit mund te jete me e madhe se 120 000 000 (njqindenzetmilion) leke, por jo me e vogel se 114 000 000 (njqindekatermbdhjetemilion) leke, qe perfaqeson nje ndryshim te investimit ne vleren 5% (pese) te investimit total te parashikuar.

Neni 10 **Programi punimeve**

Konçesionari merr përsipër të zbatojë programin e mëposhtëm kohor të punimeve :

1. Konçesionari merr përsipër të fillojë punimet për zbatimin e projektit brenda 30 (tridhjetë) ditësh nga data e leshimit te lejes se ndertimit. Aplikimi per paisjen me leje ndertimi do te kryhet brenda 30 (tridhjetë) diteve nga data e miratimit te projekt – zbatimit perfundimtar nga Autoriteti Kontraktor.
2. Konçesionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin brenda 14 (katermbdhjetë) muajve nga hyrja në fuqi e kontratës, sipas aneksit 1 bashkëlidhur.
3. Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit, nëse marrja e lejeve nga institucionet përkatëse është vonuar përtej kohës së rregullt proceduriale për marrjen e tyre.
4. Koha e shtyjes do të jetë sa koha e vonesave të krijuara nga subjektet shtetërore.

Neni 11 **Testimi i veprës**

- 11.1 Në përfundim të punimeve, duhet të kryhet testimi i vepres, për të siguruar funksionalitetin e hidrocentralit. Testimi do te filloje brenda 30 (tridhjetë) diteve nga marrja e njoftimit te bere nga Koncesionari tek Autoriteti Kontraktues.
- 11.2 Ky testim do të kryhet nën kontrollin e një grupi pune, në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të Autoritetit Kontraktues dhe të Konçesionarit, të cilët do të konkludojnë me një raport përfundimtar për vënien ose jo në punë të hidrocentralit, brenda 60 (gjashtedhjetë) diteve nga fillimi i testimit, duke patur parasysh kompleksitetin e vepres.
- 11.3 Ne rast mospjesmarrje te Autoritetit Kontraktor gjate testimit, Koncesionari ka te drejte te kryeje vete testimin dhe venien ne pune te vepres, duke njoftuar Autoritetin me shkrim, brenda 30 (tridhjetë) diteve nga testimi dhe venia ne pune.

Neni 12 Zgjidhja e Kontratës së Konçesionit

12.1 Zgjidhja e njëanshme e kontratës nga Autoriteti Kontraktues.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të zgjidhe Kontratën e Konçesionit në mënyrë të njëanshme, brenda 30 diteve pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër:

1. Kur Konçesionari nuk fillon punën për 6 muaj (per shkak te tij) nga data e marrjes se lejes se ndertimit sipas nenit 10.1. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues ka te drejte te marre vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.
2. Në rast të mosrealizimit të fuqisë së vendosur mbi 10 % të asaj sipas projektit të propozuar nga Konçesionari;
3. Kur Konçesionari transferon aksionet/kuotat, pa miratim të Autoritetit Kontraktues.
4. Kur Konçesionari braktis punimet e zbatimit per me shume se 100 (njqind) dite te nje pasnjeshme. Ne kete rast Autoriteti Kontraktues ka te drejte te mare vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.
5. Kur shoqëria e re koncesionare është ne proces falimentimi (per faj te tij) dhe/ose likuidimi. Nese është e aplikueshme, Autoriteti Kontraktues ka te drejte te mare vleren e Sigurimit te Kontrates te parashikuar ne nenin 14.
6. Kur Konçesionari nuk zbaton ndonje apo te gjitha detyrimet e tij te parashikuara ne kete Kontrate.

- 12.2 Zgjidhja e njëanshme e kontratës nuk çliron Konçesionarin nga detyrimi për të vazhduar zbatimin e kontratës deri në momentin e dorëzimit të hidrocentralit tek Autoriteti Kontraktues. Palet bien dakord qe dorezimi do te behet brenda nje afati kohor prej 60 ditesh, duke filluar nga momenti i zgjidhjes.
Nese ky detyrim nuk permbushet nga Konçesionari atehere, Autoriteti Kontraktues, ka të drejtë të marrë përsipër përkohësisht administrimin e hec-it, për sigurimin e një shërbimi të efektshëm dhe të pandërprerë.

12.3 Zgjidhja e kontratës nga secila palë.

Secila palë, ka të drejtë të zgjidhë kontratën pasi të ketë njoftuar për zgjidhjen palën tjetër, kur përmbushja e detyrimeve bëhet e pamundur, për shkak të rrethanave që kanë qenë jashtë kontrollit të arsyeshëm të secilës palë. .

12.4 Pagesat ne rast zgjidhjeje te Kontrates :

1. Autoriteti Kontraktues, ne rast zgjidhjeje te Kontrates per faj te Konçesionarit, është i detyruar t'i paguaje ketij te fundit vleren aktuale te asetëve ne momentin e zgjidhjes. Megjithate Autoriteti ka te drejte nje mbaje nje vlere te barabarte me 20 (njetzet) % nga kjo shume si penalitet

2. Autoriteti Kontraktues, ne rast zgjidhjeje te Kontrates sipas pikes 12.3 (me siper), eshte i detyruar t'i paguaje Koncesionarit nje vlere financiare te barabarte me vleren aktuale te mbetur te aseteteve ne momentin e zgjidhjes.

12.5 Zgjidhja e kontratës me konsensus:

Palët kanë të drejtë ta zgjidhin kontratën e konçesionit me pëlqim të dyanshëm, duke negociuar menyren e kompensimit te investimit. Gjithsesi, Koncesionari ka te drejte te kerkoje Sigurimin e Kontrates nese ekziston.

Neni 13 Kontratrat


- 13.1 Konçesionari ka të drejtë të lidhë kontrata sipërmarrjeje për zbatimin e punimeve të projektit dhe çdo lloj kontrate tjetër, me qëllim realizimin e objektit të konçesionit. Në të gjitha kontratat, Konçesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Kontrate konçesioni.
- 13.2 Përgjegjës para Autoritetit Kontraktues për zbatimin e rregullt të këtyre kontratave mbetet gjithmonë Konçesionari.
- 13.3 Autoriteti Kontraktues nuk merr përsipër asnjë detyrim kundrejt sipërmarrësve, furnizuesve dhe të tretëve, në rast të mosmarrëveshjeve që mund të lindin ndërmjet këtyre të fundit dhe Konçesionarit.

Neni 14 Sigurimi i kontratës

- 14.1 Konçesionari, para nenshktimit të kontratës, duhet të ketë ngurtësuar në një institucion bankar ose shoqëri sigurimesh, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, për llogari të Autoritetit Kontraktues, një shumë prej 12,000,000 (dymbëdhjete milion) leke, qe perben 10 % të vlerës totale të investimit. Formulari i sigurimit të kontratës është pjesë përbërëse, dhe i bashkelidhet kësaj kontrate.
- 14.2 Konçesionarit i lejohet të ç'ngurtësoje këtë vlerë, bazuar ne parashikimet e nenit 11, brenda 60 (gjashtedhjete) ditëve nga kryerja e testimit të veprës dhe venia ne pune.
- 14.3 Sigurimi i Kontrates do te sherbeje per te garantuar zbatimin ne menyren e duhur dhe brenda afatit te parashikuar, te detyrimeve te Koncesionarit ne lidhje me perfundimin e punimeve te ndertimit dhe perfundimin e testimit.

Neni 15 Sigurimet

- 15.1 Konçesionari duhet të sigurojë punimet e ndërtimit/montimit të objektit dhe më pas objektin e plotë gjatë gjithë kohezgjatjes se kontrates, të paktën nga rreziqet e parashikuara nga klasat e sigurimit 8 e 9 të nenit 7 te Ligjit 9267/At.29.07.2004 "Për



veprimtarinë e sigurimit, të risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurime dhe risigurime” gjatë gjithë periudhës së Konçesionit dhe do të dorëzojë pranë Autoritetit Kontraktues një kopje të tij çdo vit, brenda nje afati 15 ditor nga data e sigurimit.

- 15.2 Në rast të dëmtimeve në fazën e ndërtimit, apo gjatë shfrytëzimit të objektit vlera e dëmit e kompensuar nga siguruesi sipas kontratave përkatëse të sigurimit duhet të përdoret për të rindërtuar, riparuar, risistemuar dhe për të rikthyer objektin në gjendjen që ishte para dëmtimit.
- 15.3 Konçesionari duhet të sigurojë përgjegjësinë e tij për dëmtimet që mund t'u shkaktohen palëve të treta për shkak të ushtrimit të veprimtarisë.
- 15.4 Sigurimi do të kryhet për kufij përgjegjesie jo më të ulët se 200 000 Euro për çdo ngjarje dhe 500 000 Euro në vit. Pjesa e zbritshme nuk mund të jete më e lartë se 1000 Euro për çdo ngjarje dhe 2000 Euro në vit.
- 15.5 Autoriteti Kontraktues do të shënohet si i bashkësiguruar në të gjitha kontratat e sigurimit.

Neni 16

Tarifa konçesionare dhe vlera e riinvestimit

16.1 Tarifa konçesionare

Konçesionari duhet të paguaje për llogari të Autoritetit Kontraktues nje tarife koncesionare te barabarte me vleren e 2 % të energjisë elektrike të prodhuar në një vit.

Kjo tarifë nuk do të jetë objekt ndryshimesh deri në përfundim të kohëzgjatjes së kontratës së konçesionit.

16.2 Vlera e riinvestimit

Çdo 15 vjet Konçesionari do të riinvestojë 40 % të vlerës së investimit për makineritë dhe pajisjet. Kjo vlerë do të aktualizohet sipas indeksit të inflacionit.

Neni 17

Kufizime/Lejime

- 17.1 Për çdo transferim të aksioneve/të kapitalit themeltar të saj tek të tretët Konçesionari duhet të marrë pëlqimin paraprak të Autoritetit Kontraktues.
- 17.2 Konçesionari nuk ka të drejtë të transferojë pjesërisht apo tërësisht të drejtat dhe detyrimet e marra përsipër me këtë kontratë, përveç se kur nje transferim i tille miratohet me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.
- 17.3 Shoqëria e re që do të krijohet, sipas nenit 8.1, dhe/ose Konçesionari ka të drejtë të vendosi hipotekë, peng, apo ndonjë barrë tjetër mbi asetet që do të krijohen në

zbatim te projektit te punimeve si dhe te lidhe cdo lloj marreveshje financimi me cdo Pale Financuese, me kusht qe hipoteka, pengu apo barra tjetere si dhe marreveshja perkatese e financimit t'i sherbeje permbushjes se detyrimeve te Koncesionarit ne kete Kontrate.

Neni 18 Raportimi

- 18.1 Koncesionari është i detyruar që çdo tre (3) muaj të raportojë me shkrim pranë Autoritetit Kontraktues, realizimin e programit të investimeve në vlerë dhe në natyrë dhe më pas sasinë e prodhimit të energjisë elektrike, si dhe çdo informacion tjetër që do të konsiderohet i nevojshëm nga Autoriteti Kontraktues.

Neni 19 Legjislacioni i zbatueshem

- 19.1 Zbatimi dhe interpretimi i kesaj Kontrate Koncesioni do te bazohet ne legjislacionin shqiptar..

Neni 20 Forca Madhore dhe ndryshimet ne ligj

- 20.1 Konsiderohen ngjarje të Forcës Madhore, katastrofat e natyrës, përmbytjet, tërmetet, lufta, lufta civile, konflikte të armatosura, akte terroriste, ndotje nukleare, kimike biologjike dhe çdo ngjarje e barabartë me to, të cilat janë jashtë kontrollit të mundshëm të palëve dhe nuk ndodhin për faj të tyre, dhe që ndikojnë në objektin e kësaj Kontrate, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të palëve, por duke patur parasysh se:
- (i) ngjarje te tilla nuk mund ose nuk mundej te parashikoheshin apo shmangeshin, pavaresisht kujdesit te arsyeshem te treguar nga pala e demtuar;
 - (ii) pala e demtuar mori ose kishte mare te gjitha masat paraprake e arsyeshme, per te shmangur pasojat e kesaj ngjarjeje, qe solli si pasoje paafesine e kesaj pale per te permbushur detyrimet e Kontrates;
 - (iii) ngjarja nuk eshte ose nuk ishte, drejtepersedrejti ose jo, rezultat i ndonje mospermbushje detyrimesh te parashikuar ne kete Kontrate;
 - (iv) pala e demtuar ka derguar njoftim me shkrim pales tjetere, per ngjarjen e ndodhur, brenda 30 diteve nga ngjarja.
- 20.2 Në rastet e Forcës Madhore pala e dëmtuar duhet të njoftojë palën tjetër brenda 30 ditëve, duke i treguar dhe arsyetuar shtyrjen e përmbushjes së detyrimeve në mënyrë që të gjejnë një rrugë për të lehtësuar efektet e forcës madhore dhe të vazhdojnë kontratën.

20.3 Vonesat në përmbushjen e detyrimeve për shkak të ngjarjeve të Forcës Madhore, mund të jenë shkak për kërkesa reciproke për zhdëmtim apo për respektimin e detyrimeve kontraktore. Kufijtë e përmbushjes së detyrimeve, do të përcaktohen nga palët në marrëveshje ndërmjet tyre.

20.4 Ndryshimet ne Ligj

Cdo ndryshim i mundshëm në Ligj, i jep të drejten Konçesionarit të kërkojë sipas sipas pikes 8 e nenit 7 të kësaj Kontrate, kur këto ndryshime ndikojnë drejtpërsdrejti në objektin e kësaj Kontrate dhe/ose janë diskriminuese.

Neni 21

Hyrja në fuqi e Kontrates së Konçesionit

21.1 Kontrata e Konçesionit do të hyjë në fuqi mbasi të jetë miratuar nga Keshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me Ligjin Nr.9663, datë 18.12.2006 "Për konçensionet".

Neni 22

Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve

22.1 Çdo kundërshti, mosmarrëveshje apo ankesë midis palëve kontraktuese që lind ose ka lidhje me zbatimin dhe interpretimin e kësaj Kontrate Konçesionit, do të zgjidhet me mirëkuptim midis tyre duke u bazuar në vullnetin e mirë.

22.2 Kur me gjithë përpjekjet e palëve nuk arrihet një konsensus i përbashkët, kompetente për zgjidhjen e çdo mosmarrëveshje që lidhet me këtë Kontratë Konçesionit, do të jetë Gjykata e Arbitrazhit, që do të krijohet dhe funksionojë sipas parashikimeve të Kodit të Procedurave Civile të Republikës së Shqipërisë apo ndonjë kuadri tjetër ligjor shqiptar.


22.3 Fillimi apo vazhdimi i negociatave për zgjidhje me dialog, apo i procedurave gjyqësore të arbitrazhit nuk do të pezullojë zbatimin e projektit sipas objektit të kontratës dhe nuk do të çlirojë palët nga detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Kontrate.

22.4 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve nëpërmjet procedurave të arbitrazhit do të jetë e zbatueshme vetëm në rast se nuk bie ndesh me ndonjë rrethane, fakt apo ngjarje që e bën të pamundur ekzekutimin e këtyre procedurave. Në këto rast, mosmarrëveshja do të jetë objekt gjykimi nga gjykata e shkallës së parë Tirane.

Neni 23

Sanksionet

23.1 Mosrespektimi i afateve dhe kushteve të kësaj Kontrate, në përfundim të periudhës të parashikuar në nenin 10 të kësaj kontrate, penalizon Konçesionarin si më poshtë:

- 
- a. Për shkelje të afatit të ndërtimit 0,05 % në ditë të vlerës së investimeve të munguara.
 - b. Për moskryerje ne total të investimeve në vlerën e marrë përsipër në konkurim, Konçesionari penalizohet me 10 % të vlerës së investimeve të perealizuara.
 - c. Për çdo ditë vonese për fillimin e punimeve penalizohet me 10 000 lekë.

Keto penalitete do te mbahen nga Sigurimi i Kontrates parashikuar ne nenin 14 me siper, duke patur parasysh se nese vlera e ketij sigurimi nuk eshte mjaftueshme per shlyerjen e penaliteteteve, Koncesionari do t'a plotesoje kete shume, rast pas rasti.

Ne rast zgjidhjeje te Kontrates perpara afatit te parashikuar per zhbllokimin e Sigurimit te Kontrates, penalitetet ne paragrafet a, b dhe c nuk do te aplikohen. Ne rast te kundert, Autoriteti Kontraktues zhbllokon Sigurimin e Kontrates, duke aplikuar penalitetet ne paragrafet a, b dhe c.

- 23.2 Mosrealizimi i prodhimit të energjisë elektrike dhe fuqisë së vendosur sipas kushteve të rëna dakort me këtë kontratë, penalizon Konçesionarin si më poshtë:
 - a. Në rast mosrealizimi, për faj të Konçesionarit, të prodhimit të energjisë elektrike prej 8,400,000 KWh/vit, Konçesionari penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të pa realizuar për periudhën raportuese, duke patur parasysh se ne kete rast Autoriteti Kontraktues do ta marre te plote tarifen koncesionare prej 2% (per sasi prej 8,400,000 KWh/vit). Ne rast kur prodhimi nuk realizohet per shkaqe te tjera (jo per faj te koncesionarit), Koncesionari paguan si tarife koncesionare vleren prej 2% te prodhimit te realizuar.
 - b. Për mosrealizim deri në 10 % të fuqisë së vendosur sipas projektit të propozuar, Konçesionari do të penalizohet me 5 % të vlerës së prodhimit të energjisë elektrike të munguar, si pasojë e zvogëlimit të fuqisë së instaluar.
- 23.3 Palet bien dakord qe penalitetet e parashikuara ne paragrafet 23.2 do te zbatohen deri ne nje vlere prej 5,000,000 (pesemilion) leke. Sanksionet do te mbahen nga kjo vlere cdo fund viti kalendarik, sipas nje akti rakordimi te perbashket qe behet ndermjet paleve te kesaj Kontrate.
- 23.4 Mosparaqitja ne kohe e projektit te zbatimit per miratim nga Autoriteti Kontraktues, si e parashikuar ne nenin 8, pika 2 te kesaj kontrate koncesionare, e penalizon Koncesionarin me 0,005% te vleres se investimit.
- 23.5 Sanksionet paguhen ne llogari te Autoritetit Kontraktues. Në rast të konstatimit të shkeljeve që çojnë në aplikimin e sanksioneve sipas këtij neni, Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari do të diskutojnë për një periudhë 30 ditore lidhur me shkeljen.
- 23.6 Kur vendoset për aplikimin e sanksionit përkatës, Autoritetit Kontraktues i lind e drejta të kërkojë shlyerjen e këtij detyrimi brenda 20 ditësh. Në rast se ky detyrim nuk shlyhet në kohë, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë që së bashku me shlyerjen e detyrimit kryesor të kërkojë edhe kamatat ligjore. *N M /*

Neni 24 Rregullimi i shkeljeve

- 24.1 Kur Autoriteti Kontraktues konstaton se gjatë periudhës së konçesionit, Konçesionari ka shkelur, ndonjë prej detyrimeve të përmendura në këtë kontratë, ai menjëherë ia bën të njohura këto shkelje Konçesionarit duke pritur për një periudhë 40 ditore përgjigjen e tij, me argumentat përkatëse. Palët me marrëveshje të përbashkët, do të përcaktojnë mënyrën dhe afatin brenda të cilit do të rregullohet shkelja.
- 24.2 Kjo procedurë nuk e zhvesh Konçesionarin nga detyrimi për të paguar sanksione të tjera me efekte financiare që rrjedhin nga mospërbushja e detyrimeve.

Neni 25 Transferimi i Aseteve

- 25.1 Me mbarimin e Kontratës së Konçesionit si rezultat i përfundimit të afatit të zakonshëm ose si një mbarim i parakohshëm i saj, asetet e Konçesionit, përfshirë edhe çdo ndërtesë apo impiant të ndërtuar nga Konçesionari në kantierin e Konçesionit, duhet t'i transferohen Autoritetit Kontraktues.
- 25.2 Transferimi do të përfshijë por pa u kufizuar në to:
- Dorëzimin fizik të aseteve;
 - Dorëzimin e dokumentave që shoqërojnë këto asete;
 - Kalimin e titullit të pronësisë për ndërtesat apo impiantet e ndërtuara nga Konçesionari.
- 25.2 Konçesionari duhet të provojë se këto asete janë të mirëmbajtura dhe në gjendje të mirë pune.

Neni 26 Mbarimi i kontratës

- 26.1 Kontrata konçesionare mbaron me përfundimin e afatit 35 vjeçar, duke patur parasysh parashikimet e nenit 4.
- 26.2 Mbarimi i kontratës nuk e zhvesh Konçesionarin nga detyrimi për pagimin e detyrimeve të prapambetura ndaj Autoritetit Kontraktues dhe të tretëve.

Neni 27 Konfidencialiteti

- 27.1 Secila nga palët duhet të konsiderojë si konfidenciale të gjitha dokumentat dhe informacionet e tjera në lidhje me projektin, qofshin këto tregtare apo teknike, dhe nuk duhet t'ja bëjë të ditura një pale të tretë, të gjithë apo një pjesë të dokumentit

apo informacionit, pa miratimin e palës tjetër, përveçse për qëllimin e përmbushjes së kushteve të kësaj kontrate.

Neni 28 Ndryshime

- 28.1 Kjo kontratë mund të pesoje ndryshim, shtesa dhe/ose zevendesime vetem me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
- 28.2 Çdo ndryshim i kësaj kontrate apo anekseve bashkëlidhur saj, do të hyjë në fuqi pasi të miratohet nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e kësaj kontrate.

Neni 29 Bashkepunimi midis Autoritetit Kontraktues dhe Konçesionarit

Autoriteti Kontraktues dhe Konçesionari janë zotuar të bashkëpunojnë në mënyrë që të garantojnë realizimin e plotë të projektit.

Çdo komunikim për çdo problem ndërmjet palëve, do të bëhet vetëm me shkrim, në adresat e treguara më poshtë nga palët. Palët janë të detyruara t'i njoftojnë menjëherë njëra-tjetrës çdo ndryshim të cilesdo prej këtyre koordinatave, brenda një afati 10 (dhjetë) ditësh nga data e ndryshimit.

Për çdo ndihmë që do t'i kërkojë Autoritetit Kontraktues nga konçesionari, ky i fundit detyrohet të paraqesë kërkesën me shkrim për çka kërkon në zbatim të detyrimeve të kësaj Kontrate.

Adresat dhe numrat e faksëve zyrtare që do të përdoren janë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje janë:

Per Autoritetin Kontraktues

Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë
dhe Energjitikës
Blvd. Zogu i Parë, Nr. 1001,
Tirane - Shqipëri

Per Konçesionarin

Shoqëria "IRZ" sh.p.k.
Rruga "Don Bosko", Pallati përballë "parkut
të autobuzëve",
Tirane - Shqipëri
Cel: + 355 (0) 692055992

Neni 30 Rregjistrimi i Kontrates

Brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e saj, kjo Kontratë duhet të rregjistrohet në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

Neni 31
Anekset

31.1 Kesaj Kontrate i bashkelidhen te gjitha anekset e permendura me siper, si dhe:

- Sigurimi i Kontrates, Seria Numer 0000137, date 28.01.2008;
- Autorizimi per nenshkrimin e Kontrates, Nr. 1597/5, date 13.02.2008.

Kjo kontratë u hartua në 6 (gjashte) kopje dhe pasi ju lexua palëve, të cilët e kuptuan dhe e pranuan atë, e nënshkruan me vullnet të lirë e të plotë, dhe unë noterja e vërtetoj atë rregullisht sipas ligjit.

PALET

AUTORITETI KONTRAKTUES **KONCESIONARI**